




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË

Nr. 89 Prot.

Korçë, më 22.01.2026


Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit Nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar,

Qendra e Formimit Profesional Publik Korçë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Kuzhinë"** - 2 persona
2. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Kuzhinë" (Pogradec)** - 1 person
3. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Servis xhenerik në automjetet e lehta" (Pogradec)** - 1 person
4. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Servis xhenerik në automjetet e lehta" (Devoll)** - 1 person
5. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Parukeri"** - 1 person
6. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Estetikë"** - 1 person
7. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Rrobaqepsi"** - 1 person
8. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Berber"** - 1 person
9. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Manikyr - Pedikyr"** - 1 person
10. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Aftësi digjitale"** - 2 persona
11. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Sekretari"** - 1 person
12. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **"Aftësi për punësim"** - 2 persona



13. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **“Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike”**
--- 1 person
14. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **“Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik”**
- 1 person
15. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **“Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik”**
(Pogradec) - 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 02.02.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar,

DREJTOR I KOMANDUAR

Adela MYTEBERI

